



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

KRYETARI  
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më 03/11/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Blerje pajisje dhe mobilje për shkollën “Muhamet Shehu”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Mobilje dhe pajisje të ndryshme me Kod 39150000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,339,187 (tre milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, venë në dispozicion nga buxheti i shtetit , për objektin: “Blerje pajisje dhe mobilje për shkollën “Muhamet Shehu”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **1,335,675(një milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë)** lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

**3,339,187 x 40% = 1,335,675 Lekë.**

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi*

kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**3,339,187 x 20% = 667,837 Lekë.**

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci 2(dy) vjecare për mallrat e ofruar nga momenti i marrjes në dorëzim, si dhe ndërrimin në raste difektesh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim

kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklaratë se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit dhe montimit të të gjithë artikujve në ambientet e Autoritetit Kontraktor (shkolla Muhamet Shehu), sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një katalog ku të shënohet në mënyrë të qartë modeli i ofruar për të gjitha zerat e parashikuar në preventiv.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në gërmën b të pikës 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi, funksionalitetit dhe jetëgjatësisë së mallrave objekt prokurimi.

**2.3.5.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në gjuhën shqipe ose të përkthyer/ noterizuar), si më poshtë:

**1. ISO 9001-2015 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente (e vlefshme),** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes). Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësisë, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetin e mëposhtëm:

---

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatën e pronësisë,
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit të paraqitur. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë:

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.
- *Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.*
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.7.** Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 5/a dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. **Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.***

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimet teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit urban, projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile** duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

### SPECIFIKIME TEKNIKE

**Tavolinë nxënësi -**

Cikli i Ulët (120\*64\*45 cm)

Cikli i lartë (120\*75\*45 cm)



- Syprina MDF e melaminuar dhe e frezuar perimetralisht, duhet të ketë trashësinë inë të madhe ose të barabartë me 18 mm, me veshje laminatë në mënyrë që të durojë gërvishtje. Montimi i syprinës me skeletin duhet të bëhet me vida të fshehta ose me perçina me kokë Ø4.
- Në pjesën e poshtme të saj të jenë të vendosura nje element me permasa 110x26 cm MDF e melaminuar 16mm dhe e frezuar perimetralisht, qe sherben për mbajtje të librave të nxënësve.
- Montimi i syprinës roe skeletin te behet me vida të fshehta.
- Në pjesën ballore të vendoset nje element me permasat 10x14.5cm me material MDF e melaminuar dhe e brezuar perimetralisht.
- Këmbët vertikale duhet të jenë me profil tubolar oval ku ne te dyja anet e tubit te jete i rumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te tavolines, me seksion jo më të vogël 50x25mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa fundore do të jetë me profil tubolaroval ku ne te dyja anet i rumbullakosur jo më të vogël se 50x25mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm. Pjesa e harkut, duhet të jetë me profil tubolar me seksion jo më të vogël se 20x20mm, spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm, e lyer me boje elektrostатike ngjyrë sipas kerkeses se klientit. Në fundet e tyre të ketë tapa plastike për shmangien e zhurmave të ndryshme.
- Preferohet ngjyra e metalit e zeze ose gri.

1. **Karrige nxënësi:**


Cikli i ulët (35\*38\*37/70 cm)

Cikli i lartë (35\*38\*42-45/75 cm)



- Mbështetëset dhe ulëset të jenë me material frezilit, i derdhur ne te gjithë, trupin e ndejtjes dhe te shpines. Materiali i derdhur i frezilitit duhet te jete qendrueshme kunder lageshtires dhe gervishtjeve. Ndejtesia dhe shpina të jene te harkuara (me gropa në qendrën e ulëses dhe ne forme anatomike.
- Skeleti duhet të jetë me profiltubolar oval ku në të dyja anët e tubit të jetë rrumbullakosur, qe te japi fortesine dhe imazhin e dukshem te kariges, me seksion jo më të vogël 30 x15mm dhe spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm.
- I gjithë skeleti të jetë i salduar me saldim të vazhduar me argon dhe i lyer me bojë elektrostatische, në pjesët fundore të ketë tapa plastike.
- Ndejtesia dhe shpina eshte kusht i domosdoshem per implementimin e kontrates.

## 2. Tavoline mësuesi (120\*60\*76)



- Suprina të ndërtohet me melamine me trashësi 25mm me rezistencë të lartë kundër gervishtjeve dhe njollave
- Përmasat e suprinës të jenë l 20x60cm.
- Veshja perimetrale e të gjithë elementëve përbërës të saj të jenë PVC 0.8mm
- Pjesët anësore të jenë të të njëjtit material me përmasa 70x60cm dhe me spesor 18 mm.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues dhe me tapa për të shmangur gërvishtjet me parketin ose pllakat.
- Bashkimi i suprinës me këmbët bëhet me aksesore të padukshëm.
- Montimi dhe çmontimi të jetë sa inë i thjeshtë dhe të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

## 3. Karrige për mësues me tapiceri (510\*450\*780mm)






- Shpina dhe ulësja të jenë të bëra me plastikë të zezë, rezistente ndaj goditjeve, të mbushura me sfungjer te cilesise se larte me dendesi 40kg/m<sup>3</sup>, i ngjitur me lëndë ngjitime, për të krijuar formën ergonomike, dhe të veshura me tekstil (tapiceri).
- Pjesa e poshtme e ulëses dhe e pasme e shpinores mbulohen me kapak plastik të së njëjtës formë.
- Përmasat e ulëses të jenë: 450x400mm, ndërsa të shpinores të jenë 300x450 mm.
- Lartësitë e ulëses dhe shpinores të jenë përkatësisht 400-460mm dhe 700- 750 mm.
- Struktura mbajtëse të jetë e përbërë prej profil celiku oval me përmasa 30x15mm, me spesor jo me te vogel se 1.2 mm, i harkuar me kalandër.
- Kjo strukturë të jetë e salduar me argon ose shkarkesë elektrike dhe e lyer me furrë elektrostatische.
- Fundet e këmbëve të kenë tapa plastike të trasha 5mm për të qenë jetëgjatë në përdorimin e tyre.
- Ngjyra e karriges të jetë e zezë osë blu.

#### 4. Dollap per klasa

- Përmasat: jo më pak se 90x45x 185cm.
- Materiali i perdorur do te jete melamine me trashesi jo me te vogel se 16 mm, bordet anesore te se eilit jane te veshura me material plastik pvc me spesor jo me te vogel se 0.8 mm.
- Pjesa e pasme e dollapit është e përbërë me fibër me trashësi jo inë pak se 3mm.
- Të ketu 2 kanata me hapje 90°, doreza e brava me celës.
- I gjithë dollapi mbështetet mbi këmbë plastike me lartësi 6 cm.
- Pjesa e brendshme e dollapit do te ndahet ne 4 hapësira te barabarta me ane te 3 sergjenave.
- Lart dhe poshtë do të ketë shula për fiksimin e kanateve

#### 5. Derrase e zeze (120\*180 cm)




- Të dhënat teknike të saj janë: Mënyre tradicionale e paraqitjes. Shkruhet me shkumës. Sipërfaqe e lyster me ngjyrë e zeze ose jeshile, e lehtë për tu fshirë, falë strukturës ekstra të imët të sipërfaqes. Sipërfaqe jo gërvishëse dhe rezistente ndaj acideve. Ngjyrë e zeze ose jeshile mat, me sipërfaqe jo reflektuese.
- Dorëzimi të bëhet duke përfshirë mbajtesen e shkumësave dhe kompletin e montimit.
- Përmasat totale: 120 x 180 cm.

## 6. Karrige per kabinetet



- Lartësia totale 85cm, kurse lartësia e ndenjësës nga dyshemeja jo më pak se 44cm.
- Dimensionet e ndenjësës jo më pak se 40x40cm
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv, me seksion katror ose i rrumbullakët, i lyster me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me melaminë, sfungjer dhe stof.
- Në çdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në çdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure.
- Mbështesja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm.

## 7. Tavoline per kabinete dyshe (120\*60\*72 cm)



- Syprina të ndërtohet me melamine me trashësi 25mm me rezistencë të lartë kundër qërvishetjeve dhe njollave.
- Përmasat e syprinës të jenë 120x60cm.
- Veshja perimetrale e të gjithë elementëve përbërës të saj të jenë PVC 0.8mm.
- Pjesët anësore të jenë të të njëjtit material me përmasa 70x60cm dhe me spesor 18 mm.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues dhe me tapa për të shmangur qërvishjet me parketin ose pllakat.
- Bashkimi i syprinës me këmbët bëhet me aksesore të padukshëm.
- Montimi dhe demontimi të jetë sa më i thjeshtë dhe të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

## 8. Dollap për kabinetet e biologjise dhe kimise



- Përmasat: 90 x 45 x 165 cm.
- Skeleti dhe sergjenët do jenë prej materiali melaminë me trashësi 18 mm. Bordet anësore të skeleti, sergjenëve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC0.8mm. Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi 1.8 cm që mbyllen me celes.
- Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami me/ose pa kornize. Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të dy sergjenëve. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës prodhim, furnizim dhe montim në shkollë.

## 9. Dollap per kabinetin e fizikes



- Permasat: 90 x 45 x 185 cm.
- Skeleti dhe sergjenët do jenë prej materiali melaminë me trashësi 18 mm. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik pvc 0.8mm Poshtë fiankeve do ketë këmbëza me mekanizëm nivelues. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej materiali melaminë, me trashësi 1.8 cm që mbyllen me celes.
- Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndare në dy pjesë me anë të një sergjeni me lartësi të rregjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami me/ose pa kornize. Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të dy sergjenëve. Ngjyrat janë të ndryshme dhe percaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës prodhim, furnizim dhe montim ne shkolle.

## 10. Tavoline nxenesi dyvendeshe per kompjuter



- Përmasat e tavolinës për Deskop:
- Syprina: rreth 1400 x 700 x 750 mm
- Skeleti: rreth 1350 x 650 x 725 mm
- 2 cengela që ndodhen nga brenda për të varur cantat e nxënësve

- Syprina e punës: Melamine 18mm e borduar me PVC 0.8mm; dhe që delinbi skelet,
- Skeleti është i ndemiar me profil metalik nibolar me seksion katror 30x30mm. nie spesor jo me te vogel se 1.2 - 1.5mm këmbët metalike janë të pajisura me vidha rrotullimi lartësie për të siguruar një nivel horizontal të pavarur nga mosniveleli i dyshemesë.
- Nën syprinë majtas ose djathtas është elementi mbajtës i njësisë qendrore e bërë me materiai melaminë 18mm me përmasa : 500 x 250 x 600 mm.
- Ngjyra metal.
- Prodhim, furnizim dhe montim.

### 11. Tavoline mesuesi per kabinetin e informatikes

- Është njëllonj me tavolinën e nxënësit me ndryshim që në krahun tjetër të vendosjes së hardiskut janë të vendosur tre sirtarë te cilët montohen nën syprinën e tavolinës. me përmasa: lartësia 15 cm. gjerësia 40 cm dhe thellësia 60 cm.
- Ngjyra metal

### 12. Karrige për nxënës në kabinetin e informatikës



- Lartësia totale 85cm, kurse lartësia e ndenjësës nga dyshemeja jo më pak se 44cm
- Dimensionet e ndenjësës jo më pak se 40x40cm.
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv. me selcsion katror ose i rrumbullakët, i lyster me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me melaminë, sfungjer dhe stof.
- Në cdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në cdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure.
- Mbështesja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm.

### 13. Tavolina per biblioteke

- Përmasat: gjatësia 120 cm, gjerësia 60 cm, lartësia 74 cm, per perdorim nga studentet ne biblioteke. Syprina e tavolines duhet te jete prej material melainine 1.8 cm e borduar me PVC.
- Montimi i kembeve me suprinen realizohet nepermjet nje elementi lidhes per te siguruar qendrushmerine e tavolines me permasa 1 12x35cm. me melamine 18mm e boruar me PVC 0.8mm.
- Kembet e tavolines duhet te jene prej materiali melamine 1.8 cm me bordura PVC. Kembet te jene te vendosura mbi tapa plastike te cilat lejojne regjistrimin e lartesisë prodhim, furnizim dhe montim ne shkolle.

#### 14. Rafte biblioteke



- Rafti është i disenjuar per bibloteke. Permasat e raftit jane 90 x 40 x 185 cm
- Faqet vertikale jane me melamine me trashesi 1.8 cm me veshje perimetrale te plastifikuar me PVC 0.8 mm.
- Rafti ka gjithsej kater ndarje horizontale te brendshme. Ndareset horizontale te raftit jane melamine 25mm me veshje perimetrale te plastifilcuar me PVC 0.8mm.
- Trashesia prej 2.5 cm dhe gjatesia e lire prej 90 cm është nje gjatesi optimale e cila siguron nje hapësire te mjaftueshme, gjithashtu ruan qendrushmerine dhe nuk deformohet nen veprimin e ngarkeses se librave me kalimin e kohes. Faqja e mbrapme e raftit është me perberje fiber me trashesi 3 mm. Montimi do te realizohet me aksesore te fshehur. Prodhim, furnizim dhe montim ne shkolle.

#### 15. Karrige per biblioteke




- Lartësia totale 85cm, kurse lartësia e ndenjës nga dyshemeja jo më pak se 44cm
- Dimensionet e ndenjës jo inë pak se 40x40cm
- Skeleti të realizohet nga dru ahu masiv, me seksion katror ose i rrumbullakët, i lyer me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me melaminë, sfungjer dhe stof.
- Në pdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në cdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure.
- Mbështesja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dy ristela me gjerësi jo më pak se 5 cm ose një e vetme me gjerësi jo më pak se 10 cm.

#### 16. Tavoline drejtuesi ne forme L (e madhe)

- Përbëhet nga 4 pjesë kryesore
- Tavolinë pune (gjatësi x gjerësi x lartësi) 140 x 70 x 72 cm
- Tavolinë kompjuteri (gjatësi x gjerësi x lartësi) 90 x 70 x 72 cm
- Hark lidhës 90° me pënvasa 70 x 70
- Tavolina e mbledhjes (gjatësi x gjerësi x lartësi) 130x70x75cm
- Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm.
- Veshje laminat me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me material melamine me trashësi 18 mm.
- Bordet anësore të planit të punës dhe të kembëve të jenë të rrethuara me material plastik pvc 0.8mm.
- Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide.
- Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë.
- Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.
- Tavolina e punës në pjesën e brendshine ka të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbyllur me celës.
- Montimi dhe montimi U jetë sa me i thjeshtë.
- Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

#### 17. Tavoline dejtuesi ne forme L (e vogel)



- Perbëhet nga 3 pjesë kryesore
- Tavolinë pune(gjatësi x gjerësi x lartësi) 140 x 70 x 72 cm
- Tavolinë kompjuteri (gjatësi x gjerësi x lartësi) 90 x 70 x 72 cm
- Hark lidhës 90° me përmasa 70 x 70Cln.
- Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm.
- Veshje laminat me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave.Këmbët janë me material melaminë me trashësi 18 mm.
- Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC 0.8mm.
- Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide.
- Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plant i dyshemesë.
- Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë.
- Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.
- Tavolina e punës në pjesën e brendshme ka të montuar në njërin krah një bllok sirtarësh ku sirtari i parë të jetë i mbvllur me celës.
- Montimi dhe cmontimi të jetë sa më i thjeshtë.
- Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

## 18. Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie



- Shtylla verikale me skelet të përbërë me pesë këmbë, në formë ylli, me pesë rrota rrotulluese në formë sferike të përshtatura për dysheme me tapete.
- Zhvendosje pa shkallë të pjesës ku rri ulur, me sustë për thellësinë dhe mekanizëm çlodhës, susta e përkuljes e rregullueshme sipas peshës së trupit.
- Tapiceria e ndenjës dhe e mbështetëses e mbushur me material mbushës (sfungjer) dhe veshur me copë (stop, ngjyra sipas dëshirës së porositësit, me bordura mbrojtëse.




- Krahët e karriges: Prej plastike. Prodhirn, furniznim dhe vendosje

## 19. Karrige per sallën e mesuesve



- Dimensionet e ndenjësës jo më pak se 40x40cm
- Skeleti të realizohet nga dru ah masiv, me seksion katror ose i rrumbullakët. i lyster me llak për të ruajtur ngjyrën natyrale të drurit.
- Ndenjësja të realizohet me melaminë, sfungjer dhe stof.
- Në cdo rast duhet të sigurojnë një formë të harkuar.
- Në cdo rast do jetë e mbushur me sfungjer dhe e tapicuar me copë stofi ose lëkure.
- Mbështesja të realizohet me ristela të kurbëzuara jo më pak se dyristela me gjerësi jo më pak se a cm ose një e vetme me gjerësi jomë pak se 10 cm.

## 20. Raft per çdo mesues ne sallën e mesuesve



- Përmasat: 90 x 45 x 185 cm
- Raftet do të realizohet me 15 hapësira që qëndrojnë mbi njera tjetrën. Me lartësi të njëjtte. Hapësirat shërbejnë si sipërfaqe mbajtëse të pajisjeve të klasës

- Pjesa e pasme e dollapit eshte e perbere me fiber, në faqen e dukshme mc te njejten ngjyre dhe dizenjo me pjesen tjeter te dollapit. Per cdo hapësire te kete kanata me hapje 90°, doreza e brava me çeles.
- I gjithë rafti mbështetet mbi kembeza plastike 6 cm. Materiali i gjithë dollapit do jetë melamine me trashesi 1.8cm. Trupi, ndarëset për të gjitha pjesët e dukshme vishen material plastic PVC (ne pjeset anesore).
- Ndarjet horizontale të raftit prej pllake zdrukthi e melaminuar me trashesi 1.8cm.
- Lidhja do te realizohet me aksesor të fshehura. Prodhim, furnizim dhe montim ne shkollë

### **21. Dollap per arkivin (90\*40\*195 cm)**

- Përmasat (gjerësi x thellësi x lartësi): 90 x 40 x 195 cm
- Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej celiku të lyer që t'i rezistojë korozionit dhe përkuljes.
- Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me celës.
- Hapësira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira.
- Sergjenüt ndarës duhet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg.
- Montimi dhe cmontimi të jetë sa më i thjeshtë.
- Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre dotë bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

Specifikimet teknike jane bere per permbushjen e nevojave te Autoritetit Kontraktor sipas hapësirave që ka në dispozicion .

Në zbatim të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” apo origjinë, përfshihet termi ose ekuivalenti i tij/saj”.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mobiljet e ofruara nga operatori ekonomik ofertues duhet te jene ne permasat e dhena ne specifikimet teknike te cilat shoqerojne keto kritere.

Përcaktimi i saktë i ngjyrave do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të marrë përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit, ngritjen ne katet perkatese te mobiljeve, cmontimin dhe heqjen e mobilje ekzzistuese si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Gjithashtu operatori ekonomik do te beje mbledhjen dhe largimin e te gjitha ambalazheve apo mbeshtjelljet e mobiljeve te dorrezuara dhe depozitimin e tyre ne vendet e caktuara per depozitimin e tyre.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **16/11/2023, ora 11:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje pajisje dhe mobilje për shkollën “Muhamet Shehu”**

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit.

**Njësia e Prokurimit:**